

KARTËMONËDHA 5000 LEKË KARTËMONËDHA JONË E RE: E SIGURT DHE MODERNE

PSE NJË SERI E RE?

Një nga përgjegjësitë kryesore të Bankës së Shqipërisë është të garantojë besimin e publikut te paraja kombëtare. Ajo e bën këtë duke emetuar një kartëmonedhë që i komunikon publikut shqiptar siguri dhe qëndrueshmëri.

20 vjet pas hedhjes në qarkullim për herë të parë të serisë aktuale të kartëmonedhave Lek, natyrshëm ka lindur nevoja për përmirësim, me elemente të reja, për t'i bërë ato më të sigurt ndaj falsifikimit. Kartëmonedhat tona shërbejnë edhe si mbartëse të elementeve të identitetit kombëtar. Përmes mjeshhtërisë artistike, ato promovojnë historinë e Shqipërisë dhe theksojnë kontributet e personaliteteve të saj.

Për këto arsye, Banka e Shqipërisë ka emetuar një seri të re të kartëmonedhave Lek, me pamje të rifreskuar dhe elemente sigurie të përmirësuara. Kjo seri është prodhuar me teknologjinë më të fundit të fushës, ndërkohë që edhe pamja e kartëmonedhave do të jetë më moderne.

PREZANTIMI GRADUAL I SERISË

Seria e re e kartëmonedhave do të hidhet në qarkullim gradualisht, duke filluar me prerjet 200 dhe 5000 Lekë në vitin 2019, ndërsa gjatë viteve 2020-2022 do të vijojë hedhja në qarkullim e prerjeve të tjera.

Kartëmonedhat ekzistuese do të vazhdojnë të qarkullojnë dhe të kenë kurs ligjor si mjet pagese, së bashku me kartëmonedhat e reja.

KËSHILLA PËR PËRDORIMIN E KARTËMONEDHAVE

Kartëmonedha përbën një vlerë kombëtare.

Trajtoje kartëmonedhën ashtu siç është: më shumë se një letër me vlerë. Përveçse mbart vlerën nominale, ajo paraqet një ndërthurje të vlerave artistike me elemente të identitetit kombëtar.

Ruaje kartëmonedhën në portofol

Mos e dëmto duke e rrudhosur, përthyer, shkruar, ngjyrosur, prerë, ngjitur ose lagur atë. Kështu, ti ndihmon që ajo të qëndrojë në qarkullim sa më gjatë.

DHE MOS HARRO!!!

Lexo dhe përdor shifrën që shkruhet mbi kartëmonedhë! Mos i shto një 0! Mos e quaj as të vjetër, as të ri! Ai quhet thjesht LEK. Kërkoju edhe të tjerëve ta respektojnë atë, njësoj si ti.

Për më shumë informacion vizito www.bankofalbania.org

5000

BANKA E SHQIPËRISË



NA00000000



2017

Geant Lajtha
GUVERNATORI

Agim Vajza
DREJTORI

PESË MIJË LEKË

NA00000000

ELEMENTET E SIGURISË

Kontrollo nëse kartëmonedha është e vërtetë, përmes verifikimit të elementeve të sigurisë me metodën “PREK, SHIKO, LËVIZ”.

PREK

Preke dhe ndieje kartëmonedhën me gishta.

Letra e kartëmonedhës është prodhuar nga pambuku dhe karakterizohet nga një tingëllim dhe konsistencë e veçantë.

- 1 Shtypi i ngritur:** Ndieje shtypin e ngritur të numrat, shkronjat, portreti, si dhe vijat e shkurtra përgjatë skajit të majtë dhe të djathtë të kartëmonedhës, që përbëjnë dhe elementin e njohjes së kartëmonedhës nga të verbrit.

SHIKO

Mbaje kartëmonedhën kundrejt dritës dhe shikoje me kujdes.

- 2 Figurat ujore:** Portreti i kartëmonedhës, vlera nominale e saj dhe simboli i stilizuar i shqiponjës bëhen të dukshme.
- 3 Filli i sigurisë:** Nga një shirit i ndërprerë, filli i sigurisë kthehet në një vijë të errët të pandërprerë. Në të dallohen vlera 5000 Lekë dhe një stilizim i mburojës dhe shpatës.

LËVIZ

Lëviz kartëmonedhën në kënde të ndryshme shikimi, për të parë si ndryshon.

- 4 Holograma,** shiriti i argjendtë në të majtë, shfaq me radhë logon e Bankës së Shqipërisë, portretin e Skënderbeut, vlerën nominale 5000 Lekë dhe mburojën me shpatë.
- 5 Figura me ngjyrë të ndryshueshme:** përkrenarja e Skënderbeut në cepin e sipërm djathtas ndryshon ngjyrë, nga e artë në të gjelbër, me një efekt dinamik të figurës lart e poshtë.
- 6 Filli i sigurisë** ndryshon ngjyrë nga e gjelbër në të purpurt.
- 7** Në faqen e pasme të kartëmonedhës, **shiriti i shndritshëm** në zonën qendrore shfaq të shkruar vlerën 5000 Lekë.

